



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 33 dt.27.03.1996

Këshilli Bashkiak, i mbledhur me dt.27.03.1996, mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, bazuar në dosjen Nr.1824, për ish pronarin Metan Zala, materiali i lart përmendur u studiua dhe u miratua nga Komisioni i Shërbimeve Publike të cilin ja kaloi për miratim Këshillit Bashkiak

**VENDOSI**

1. Mbi bazën e ligjit Nr.7698, dt.15.04.1993 të nenit.16, Metan Zala (trashëgimtarët e tij), kompesohen me 5.000 m<sup>2</sup> truall të lirë shtetëror, sipas gen – planit të hartuar nga Kadastra Urbane i cili ndodhet në rrugën nacionale Tiranë – Durrës në vijim të familjes Pazari, përballë firmës Gintash.
2. Për truallin në fjalë është miratuar në KRRT sheshi i ndërtimit.
3. Me kompesimin e pronarit Metan Zala, familjeve Kaloshi dhe Vashaj sipas propozimit të Ministrisë së Mbrojtjes me shkresën Nr.1433, dt.30.03.1995 si dhe të Komitetit të Përndjekurve Politikë Nr.3, dt.13.09.1993, banesat e liruara nga ristrukturimi i ushtrisë në rajonin e Aerodromit, që ndodhet në truallin e pronarit Metan Zala, të cilat ju janë bërë transferim kapital, Komiteti të Përndjekurve Politikë, me këtë vendim të Këshillit Bashkiak Nr..., dt.27.03.1996 kthehen në fond banese për të përndjekurit politike të familjeve Kaloshi dhe Vashaj.

4. Prona figuron e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.143,  
dt.27.02.1939.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**